Në bazë të statutit të FGJK-së, Kreu V, neni 29, Bordi i FJGK-së miratoj:

RREGULLOREN E REPREZENTACIONIT TË FGJK-SË, EKIPT PËRFAQËSUES

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me rregulloren mbi punën e përfaqësueses së Kosovës përcaktohet mënyra e veprimtarisë, të drejtat dhe obligimet, kushtet e punës së drejtorit, trajnerëve dhe anëtarëve tjerë të ekipit të Përfaqësueses.
Për sa i përket përmbajtjes dhe organizmit, ekipet gjimnastikore të Kosovës veprojnë si rezultat i arritjeve më të mëdha në sportin e gjimnastikës në Republikës e Kosovës, të përcaktuar sipas moshës, kategorisë dhe gjinisë:

Gjimnastika artistike për Meshkuj

- **Fatos**
- **Pionier,**
- **Junior,**
- **Senior.**

Gjimnastika artistike për Femra:

- **Yllka**
- **Pioniere,**
- **Juniore,**
- **Seniore.**

Gjimnastika Ritmike:

- **Yllka**
- **Pioniere,**
- **Junioret,**
- **Senioret.**

Neni 2.

Përfaqësuesja e Kosovës në Gjimnastikë është shqetësimi dhe krenaria e çdo anëtari të Federatës së Gjimnastikës së Kosovës (FGJK).

Neni 3.

Sigurimi i kushteve të punës dhe krijimi i parakushteve për arritjen e suksesit sportiv të Përfaqësuesës së Kosovës në Gjimnastikë është detyrë e të gjitha organeve të Federatës, si dhe të çdo anëtari të FGJK-së.

Neni 4.

Interesat e Përfaqësuesës së Gjimnastikës Kosovare dhe anëtarëve të FGJK-së, kanë përparësi në veprimin e aktivitetet e FGJK-së.

Neni 5.

Përfaqësuesja e Kosovës në Gjimnastikë, përbëhet nga gjimnastë/te të përzgjedhur/ra dhe anëtarë të udhëheqjes profesionale dhe teknike të ekipit. Gjimnastët/tet e Përfaqësuesës zgjidhen nga kryetrajneri / përzgjedhësi.

Neni 6.

Para të gjitha garave kryesore, kryetrajneri / përzgjedhësi, janë të detyruar të përgatisin një plan-program të detajuar dhe afatgjatë të punës me ekipet përzgjedhëse, dhe me një përzgjedhje më të gjërë përfaqësuesish të pranuar nga Bordi Ekzekutiv i FGJK-së.

Neni 7.

Për të gjitha pjesëmarrjet në gara ndërkomëtare, Bordi Ekzekutiv i FGJK-së, me propozimin e Kryetarit emëron udhëheqësin e ekipit.

II. KLUBET

Neni 8.

Klubi nga radhët e të cilit është përzgjedhur gjimnasti/tja, për Përfaqësuesen, është i detyruar t'i lejojë gjimnastit/tës, të marr pjesë në të gjitha fazat përgatitore të Përfaqësuesës.

Neni 9.

Anulimi i pjesëmarrjes në programet e veprimeve të Përfaqësuesës, mund të bëhet vetëm atëherë kur gjimnastet/ët kanë arsye të fortë, dhe duke treguar arsyen dhe atë brenda afatit të përcaktuar në ftesë.
Arsye e justifikueshme nënkupton vdekjen ose sëmundjen e rëndë të ndonjë anëtari të ngushtë të familjes, lëndimin ose sëmundjen e rëndë të një të përzgjedhuri. Shkalla e lëndimit ose e smundjes së gjimnastit përcaktohet nga mjeku kompetent, mjeku i kombëtarës.

Neni 10.

Në rast të mungesës së arsyes së një gjimnasti/te të përzgjedhur për Përfaqësuese, fajtor për këtë do të jetë klubi nga vjen gjimnasti/ja dhe vetë gjimnasti/ja, si dhe klubi do t'i nënshtrohen dispozitave sanksionuese të Rregullorës së Disiplinës së FGJK-së, që nënkupton përjashtimin nga Përfaqësuesja, si dhe fillimin e masave disiplinore kundrejt atij/saj.

III. GJIMNASTËT

Neni 11.

Përfaqësuesit e përzgjedhur, si më të përzgjedhurit e Përfaqësuesës të Gjimnastikës së Kosovës, janë të detyruar të kujdesen për përfaqësimin e denjë të gjimnastikës Kosovare dhe Republikës së Kosovës, dhe të janë shembull për të gjithë sportistët.

Neni 12.

Përfaqësuesi i Kosovës duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.

Neni 13.

FGJK, përfaqësuesit dhe trajnerët, do t'i mbështet me të gjitha mjetet e nevojshme. Sipas mundësive përfaqësuesve të Kosovës, FGJK do i sigurojë pajisje, veshje sportive për kohën e tyre të lirë, si dhe kostume për raste ose takime zyrtare. Përfaqësuesit e Kosovës janë të obliguar që gjatë gjithë aktiviteteve/aktivitetit, t'i bartin pajisjet sportive dhe garderobën e ofruar nga FGJK, dhe pas aktiviteteve/tit t'i kthejnë të njejtat tek personi kompetent i FGJK-së.

Përfaqësuesve të Përfaqësuesës, u ndalohet rreptësisht paraqitja me pajisje dhe veshje zyrtare të FGJK-së, në kampionate kombëtare, në këto gara, garuesit janë të detyruar që të përformojnë ekskluzivisht me pajisje dhe veshje të ofruara nga klubet e tyre.

Mosrespektimi i kësaj dispozitet është subjekt i masave disiplinore.

Përfaqësuesit e Përfaqësuesës janë të detyruar të mbajnë pajisjet e tyre zyrtare ose veshjet në mënyrën e një sportisti shembullor. Në rast se një pjesë e pajisjeve apo veshjeve zyrtare dëmtohet apo humbet nga pakujdesia, atëherë nga përfaqësuesi përgjegjës për këtë veprim do të kërkohet që të paguaj për atë dëmtim ose humbje. Në rast të sjelljeve të përsëritura të pakujdesisë ndaj pajisjeve ose veshjeve, atëherë ndaj anëtarit të Përfaqësuesës do të filloj procedura disiplinor.

Neni 14.

Gjimnasteve/ëve si dhe kryetrajnerit / përzgjedhësit, FGJK do ndajë mirënjohje dhe dhe çmime tjera për punën dhe sukseset e tyre.

Neni 15.

FGJK do të mbaj regjistërin (monitorimin) e punës të të gjithë përfaqësuesve. Evidenca do të regjistrohet nga momenti i parë kur përfaqësuesi thirret për në stërvitje/prova komëtare të cilët do selektim.
Përmes evidencës do të përcillet zhvillimi i gjimnasteve/ëve, puna e tij/saj, zhvillimi psikofizik dhe faktet e tjera relevante të nevojshme për zhvillimin e gjimnastit/ës, dhe vlerësimi i aftësive

të tyre, të gjitha këto vlerësime do t'i ndohmojnë çdo kryetrajneri / përzgjedhësi, gjatë punës dhe përzgjedhjes së gjimnasteve/ëve, për përbërjen e seleksionimeve individuale.

IV. KRYETRAJNER / PËRFAQËSUES I KOMBËTARËS PËR FEMRA - MESHKUJ

Neni 16.

Kryetrajner mundet me qenë edhe trajneri i Përfaqësuesës. Propozimi për emërimin e personave si trajnër / përzgjedhes jepet nga Bordi Ekzekutiv i FGJK-së.
Nëse kryetrajneri nuk është edhe përzgjedhës i Përfaqësuesës, Bordi Ekzekutiv i FGJK-së, është i detyruar të miratojë propozimin për emërimin e dy personave me listë të detyrave, detyrat dhe përgjegjësit e personit të propozuar për përzgjedhësin e Përfaqësuesës, dhe detyrat dhe përgjegjësit e personit të propozuar për kryetrajner, duke u bazuar në këtë rregullore.
Varësisht nga ngarkesa e aktivitetit, kryetrajneri / përfaqësuesi mund të kërkojë edhe trajner tjerë ndihmës për aktivitete të cilat propozime miratohen nga Bordi Ekzekutiv i FGJK-së.

Kryetrajneri / përfaqësësuesi i Përfaqësuesës është një përson i formuar profesionalisht që drejton drejtëpërdrejt punën profesionale, stërvitjen dhe garat e ekipit kombetarë.

Neni 17.

Krytrajneri / përzgjedhësi i Përfaqësuesës emërohet nga Bordi Ekzekutiv i FGJK-së, për një periudhë 4-vjeçare (një cikël olimpik).
Në fund të mandatit të tij, kryetrajneri / përzgjedhësi mund të rizgjedhet. Numri i cikleve nuk është i kufizuar.

Neni 18.

Që një përson të zgjidhet krytrajner / përzgjedhës i Përfaqësuesës, duhet të plotësojë këto kushte:

- Të ketë një kualifikim të lartë profesional (diplomë universitare të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sporteve, master apo Phd) dhe rezultate të dëshmuara në drejtimin e Përfaqësuesës, do të thotë gjimnastët më të mirë, të cilët janë të dëshmuar dhe kanë rezultate dhe arritjet më të mëdha në Kosovë.
- Të ketë eksperiencë 3 vjeçare në programe dhe stërvitjen e gjimnastëve dhe Përfaqësuesës,
- Të njoh një nga gjuhët zyrtare të Federatës Ndërkombëtare të Gjimnastikës FIG.

Neni 19.

Kryetrajneri / përzgjedhësi është përgjegjës për organizimin e punës për të gjitha përzgjedhjet.
Kryetrajneri / përzgjedhësi i Përfaqësuesës mund të jetë edhe një trajner që punon në klubin e tij vendas, dhe për punën e tij me ekipet kombëtare mund të marrë një kompensim monetar, i cili është i përshtatshëm për ditet dhe orët e punës së kaluar me kombëtarën – ekipet. Masat e

kompensimit monetar caktohet nga Bordi Ekzekutiv i FGJK-së me vendim të veçantë, ose kontratë.
Një trajner profesionist i angazhuar në ekip kombëtar, nuk mund të jetë në të njejtën kohe edhe trajner i klubit.

Neni 20.

Kryetrajneri / përzgjedhësi është i pavarur në punën e tij operative, dhe ai përgjigjet për punën e tij para Bordit Ekzekutiv të FGJK-së, dhe Presidentit të FGJK-së.

Neni 21.

Detyrat e krytrajnerit / përzgjedhësit në bashkëpunim me Bordin Ekzekutiv janë:

- Zhvillimi i strategjisë për zhvillimin e gjimnastikës në çdo cikël olimpik,
- Përgatitja e propozimeve për planin vjetor të punës dhe planin financiar të Përfaqësuesës,
- Planifikimi dhe parashikimi i rezutateve sportive të Përfaqësuesës në planet vjetore dhe katërvjeçare të përformancës së Përfaqësuesës.
- Analiza e rezultateve të arritura të Përfaqësuesës dhe krahasimi me parashikimet e trajnerëve të klubit bazuar në programet e planifikuara individuale të punës së përfaqësuesve.
- Përcaktimi i një liste më të gjërë të anëtarëve të Përfaqësuesës për çdo cikël të ardhshëm garash,
- Përgatitjen dhe menaxhimin profesional të stërvitjeve dhe garave të Përfaqësuesës,
- Vështrim dhe analizë e programeve individuale të punës së përfaqësuesëve në klube, të cilat përgatiten nga trajnerë personal të Përfaqësuesës në klube dhe mbikëqyrjen e zbatimit të programit.
- Propozimin e përmirësimeve dhe korrigjimeve për sportin e gjimnastikës, mbi bazën e të rëndësishmëve, argumentet që karakterizojnë sportin e gjimnastikës, sipas rregullave të FGJK-së, për arrtijet më të rëndësishme sportive të sportit të gjimnastikës.
- Përgatitja e propozimeve për programet vjetore dhe katërvjeçare të punës për Përfaqësuese,
- Përgatitja e një propozimi për një plan përgatitor të Përfaqësuesës,
- Përgatitja e një propozimi për kalendarin e garave të Përfaqësuesës për sezonin e ardhshëm, duke u kujdesur që garat vendore të jenë në funksion të ecurisë së suksesshme të ekipeve kombëtare në garat ndërkombëtare.
- Krijimi i një liste më të gjërë dhe më të ngushtë të kandidatëve për Përfaqësuese,
- Propozimi për vendin, kohën dhe datën e mbajtjes së përgatitjeve,
- Përgatitja e një propozimi për emrin e Përfaqësuesës për vlerësime dhe çmime në bazë të rezultateve të arritura,
- Përgatitja e propozimeve për emrat e trajnerëve të tjerë të Përfaqësuesës.

Neni 22.

Kretrajneri / përzgjedhësi menaxhon dhe koordinon në mënyrë operative:

- Përgatitjet dhe proceset e trajnimit – stërvitjeve,

- Punën e trajnerëve të të gjithë Përfaqësuesës,
- Me përzgjedhjen e duhur në një konkurs brenda ose jashtë vendit,
- Detyra me trajnerë të klubeve për të punuar me gjimnastë në mënyrë individuale të Përfaqësuesës.

Neni 23.

Kryetrajneri / përzgjedhësi monitoron ecurinë dhe zhvillimin e gjimnastëve më të rinj, kandidatët e mundshmë për Përfaqësuese, si dhe punën, rezultatet dhe formën e tyre.

Neni 24.

Kryetrajneri / përzgjedhësi bashkëpunon me gjimnastët, trajnerët e klubeve dhe ekspertë të profesioneve tjera për të krijuar kushte për arritjen e rezultateve të larta sportive.

Neni 25.

Bashkëpunimi me trajnerët e klubeve është shprehimisht i detyrueshëm gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të programeve individuale.
Trajnerët e klubeve janë të detyruar të paraqesin një raport me shkrim kryetrajnerit për çdo garë dhe përgatitje në të cilat marrin pjesë gjimnastët për Përfaqësuese brenda 10 ditëve nga fundi i veprimit.
Kryetrajneri / përzgjedhësi është i detyruar të e paraqes një raport për përgatitjet dhe garat, Bordit Ekzekutiv jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të një gare të caktuar.
Kryetrajneri / përzgjedhësi dhe të gjithë trajnerët janë të detyruar të respektojnë dispozitat e nenit 13. të kësaj rregullore.

Neni 26.

Kryetrajneri / përzgjedhësi është i detyruar të marr pjesë në punën e seancave të Bordit Ekzekutiv me ftesë.

Neni 27.

Kryetrajneri / përzgjedhësi mund të shkarkohet edhe para përfundimit të periudhës së mandatit (ciklit olimpik) si në rastet e cekura më poshtë:

- Nëse nuk ka rezultate të kënaqshme për shkak të zbatimit joefikas të planit dhe programit të punës së Përfaqësuesës,
- Nëse veprimet e tij dëmtojnë reputacionin e sportit të gjimnastikës dhe veçanarisht reputacionin e Republikës së Kosovës,
- Në të gjitha kushtet tjera të përcaktuara me ligj.

Për shkarkimin e kryetrajnerit / përzgjedhësit propozimin e bëjnë:

- Kryetari i FGJK-së,
- Bordi Ekzekutiv i FGJK-së,
- Komisioni Disiplinor i FGJK-së.

Në rastin e zgjedhjes së një kryetrajneri / përzgjedhësi të ri, para përfunimit të përiudhës së mandatit të përcaktuar me këtë rregullore, përsoni i sapo emëruar do të mbajë detyrën deri në fund të mandatit, do të thotë deri në një vendim të ri të dalur nga Bordi Ekzekutiv i FGJK-së.

V. KUJDESI SHËNDETËSOR

Neni 28.

Për kujdesin shëndetësor të anëtarëve të Përfaqësuesës kujdeset Komisioni Shëndetësor i FGJK-së, i cili emërohet nga Bordi Ekzekutiv.
Mjekët e ekipit kombëtar janë të detyruar që të mbajnë shënime mbi shëndetin individual të të gjithë Përfaqësuesëve dhe përzgjedhesëve të Përfaqësuesës me historikun e sëmundjeve dhe dëmtimeve, smundjet e shpeshta dhe dëmtimet, si dhe terapitë e aplikuara.

Neni 29.

Mjekët e Përfaqësuesës bashkëpunojnë me mjekët e klubeve dhe kanë të drejtë të shohin trajtimin mjekësor të kombëtarës dhe kandidatëve për Përfaqësuese.

Neni 30.

Kujdesi shëndetësor në Përfaqësuese gjatë përgatitjeve dhe paraqitjeve sigurohet nga mjeku i Përfaqësuesës i emëruar nga Bordi Ekzekutiv.

Neni 31.

Për zbatimin e dispozitave dhe kontrollin e zbatimit të kësaj rregulloreje përgjegjës i drejtëpërdrejt është Sekretari i Përgjithshëm i FGJK-së, i cili raporton menjëherë Kryetarin dhe anëtarët e Bordit Ekzekutiv të FGJK-së, për mospërputhje ose shkelje të kësaj rregullore.

Neni 32.

Rregullorja është miratuar nga Bordi Ekzekutiv i FGJK-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 21/05/2026

Kryetari i FGJK-ës:
Shkumbin Maqastena

Sekretari i Përgjithshëm i FGJK-së
Amir Tahiraga